

SHPALLJE E VENDI TË LIRË TË PUNËS**Tabela .1**

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Inter vista	Fillimi	Mbarimi
1	Teknik i mesem (Hidraulik)	Reparti ushtarak nr. 3002, Rinas, Forca Ajrore	Rinas, Tiranë	E pacaktuar	Me dosje	-	14.10.2021	28.10.2021

Formulari nr. 1

1. Pozicioni i punës:	Teknik i mesem (Hidraulik)
2. Kodi i pozicionit:	C2
3. Reparti/Institucioni:	Reparti Ushtarak nr. 3002, Forca Ajrore
4. Vendi:	Rinas
5. Paga:	Trajtohet me pagë sipas VKM nr. 202, datë 15.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa ne Vendimin nr. 717, datë 23.06.2009 të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nënpunësve të disa institucioneve buxhetore”, të ndryshuar, Lidhja nr.II/I (renditja e pozicioneve të përgjithshme të punës për cdo klasë për punonjësit mbështetës në administratën e institucioneve rajonale dhe vendore, si dhe institucioneve qendrore të grupit të tretë të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes), urdhrat të Ministrit të Mbrojtjes nr.1706, datë 13.10.2015 “Për shtesat mbi pagë për punë të vështirë e të dëmshme për shëndetin”.
6. Lloji i kontratës së punës:	E pacaktuar
7. Data e fillimit të aplikimit:	14.10.2021
8. Data e mbylljes së aplikimit:	28.10.2021
9. Mënyra e aplikimit:	Me dosje
10. Dokumentat e aplikimit:	Aplikantët duhet të paraqesin dokumentat e mëposhtëm; • Kërkesën personale; • Formularin e aplikimit; • Fotokopje të kartës së identitetit; • Dëftesën e shkollës së mesme të noterizuar me origjinalin; • Diplomë e arsimit të lartë/listë notash të noterizuar me origjinalin; • Fotokopje e patentës nëse ka; • Çertifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja; • Raport mjekësor;

- Fotografi me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12, 2 copë;
- Dëshmi penaliteti;
- Vërtetim gjykata;
- Vërtetim prokurorie;
- Librezë pune;
- Jetëshkrim (CV);
- Formulari i vetëdeklarimit;

10. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- Grada/Titulli: Civil II;
- Arsimi : I Mesëm;
- Kualifikimi: Të ketë përfunduar kursin profesionaln të hidraulikut;
- Trajnimi: Kurse dhe kualifikime te ndryshme në fushën që mbulon;
- Eksperienca në Punë: 3 vjet deri në 5 vjet;
- Gjuha e huaj: E paaplikueshme;
- Kërkesa të tjera specifike: Të ketë eksperience të mëparshme në fushën që mbulon;
- Niveli i certifikatës së sigurisë; E paaplikueshme

11. Përshkrimi i punës:

Detyrat kryesore:

- Organizimi dhe koordinimi i punës për mbajtjen në gadishmëri të sistemit të shpërndarjes së ujës-jellësit.
- Të kujdeset dhe mirëmbajë sistemin e furnizimit me ujë të ambjenteve të punës dhe stervitjes në repart.
- Të mirëmbaje sistemin kullues në territorin e repartit.
- Të raportojë rregullisht tëk eprori për kontrollet e bëra dhe problemet e konstatuara.
- Të kontrollojë në mënyrë periodike dhe të punojë për mbajtjen në gadishmëri të sistemit të MNZSH
- Mund të kërkohet që të kryejë dhe detyra shtesë në përshtatje me nevojat e shërbimit.

Përgjegjësitë: Përgjigjet për riparimin dhe mirëmbajtjen e të gjithë sistemit të shpërndarjes së ujës-jellësit ambjenteve, objekteve dhe higjenizimin e tyre.

12. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta.
Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Komisioni i ngritur me urdhër në Komandën e Forcës Ajrore, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët.

Komisioni verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit.

Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurrimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse);

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.

SHEFI I PERSONELIT

NËNKOLONEL VLADIMIR JAUPI